



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

LIGJ

Nr. 60/2018

**PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES NDRYSHUESE ME SHKËMBIM
NOTASH QË PËRDITËSON MARRËVESHJEN NDËRMJET REPUBLIKËS
SË SHQIPËRISË DHE ZYRËS SË POLICISË EUROPIANE (EUROPOL) PËR
BASHKËPUNIMIN STRATEGJIK DHE OPERACIONAL, RATIFIKUAR
ME LIGJIN NR. 28/2014**

Në mbështetje të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Ratifikohet marrëveshja ndryshuese me shkëmbim notash që përditëson marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Zyrës së Policisë Europiane (Europol) për bashkëpunimin strategjik dhe operacional, ratifikuar me ligjin nr. 28/2014, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij ligji dhe është pjesë përbërëse e tij.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 20.9.2018